

QILIMI I KUKËSIT: THURJA E NATYRËS, HISTORISË DHE KULTURËS



QILIMI I KUKËSIT: THURJA E NATYRËS, HISTORISË DHE KULTURËS



Guida është prodhuar nga Instituti i Kërkimeve Urbane, në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Kukës, si pjesë e projektit 'ECOROUTES – Shtigje Eko-Turizmi në Zonën Ndërkufitare për Promovimin e Turizmit Alternativ', në kuadër të Thirrjes së tretë për Projekt Propozime për Programin Ndërkufitar IPA II CBC Shqipëri – Kosovë 2014-2020.

Kjo guidë është bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e saj është përgjegjësi e vetme e projektit dhe autorit dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.




Copyright © 2023 Instituti i Kërkimeve Urbane.
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Tiranë, 2023.

VIZITO KUKËSIN

Zbuloni bukurinë e fshehura në këtë destinacion të paharrueshëm, nga lartësitë e majave malore tek thellësitë e traditave të lashta, aty ku natyra dhe kultura qëndrojnë së bashku. Guida ju udhëheq në një rrugëtim të pasur dhe të shkurtër nëpër historinë dhe karakteristikat e veçanta të Kukësit, duke nxjerrë në pah çdo detaj që bën këtë qytet të jashtëzakonshëm.





Harta e ndarjes administrative të Kukësit



PËRMBAJTJA

Historia	14
Gjeografia dhe Klima	30
Biodiversiteti	42
Kultura	54
Shtigjet më të reja	68
në Kukës	
Guida Turistike	98
Transporti	96

HISTORIA

Epoka e Bronzit

Gjurmët e popullimit njerëzor në atë që sot është Qyteti i Kukësit datojnë që në epokën e bronzit, gjatë së cilës popuj të lashtë si ilirët, dardanët, dhe romakët themeluan vendbanime në këtë zonë. Varreza të ndryshme ilire janë zbuluar në afërsi të Kukësit të vjetër, në fshatrat Kënetë dhe Kolsh, të cilat datojnë që në periudhën Neolitike¹.

Periudha Neolitike

1978

Kukësi i vjetër ka qenë i populluar në mënyrë të pandërprerë që prej kësaj periudhe, deri në vitin 1978, kur regjimi komunist i asaj kohe vendosi të ndërtojë digën e Fierzës, duke e përmbytur Kukësin e vjetër nën ujërat e liqenit. Në periudha thatësire dhe të uljes së nivelit të ujit, një pjesë e Kukësit të vjetër mund të shihet me sy të lirë. Kukësi i ri u popullua në vitin 1978, megjithatë ndërtimet filluan që në vitin 1962.

Sot

Sot, Kukësi shpalos një pasqyrë të pasur të historisë së tij, duke ofruar një kombinim unik të trashëgimisë së kaluar dhe modernizmit. I shtrirë nën ujërat e liqenit, Kukësi i vjetër sjell emocionet e një qyteti të humbur, ndërsa Kukësi i ri së bashku me tunelet e tij, ofron një eksperiencë interesante për vizitorët e sotëm.

2000 Çmimin Nobel

Në vitin 2000, qyteti i Kukësit u nominua për Çmimin Nobel për Paqe pasi strehoi 450 mijë shqiptarë nga Kosova, të cilët u zhvendosën në Kukës për shkak të gjenocidit serb.

Fotografi e CRISTINA GARCÍA RODERO, 1999, Kukës



Urbanistika



Kukësi Vjetër



Kukësi Vjetër
*Foto nga Safet
Dokle*



Kukësi Ri,
në fillim
të tij
Foto nga Vox

Kukësi Ri
*Foto nga
Shutterstock*



Kukësi Ri,
Viti 1978
*Foto nga
Ramadan Dokle*



Kukësi Ri,
Viti 2000



TUNELET

Nën qytetin e Kukësit, mund të zbuloni një pjesë të historisë së Shqipërisë nëpërmjet tuneleve të ndërtuara gjatë periudhës komuniste. Ky projekt, filluar në vitin 1970 dhe ndërprerë pas rënies së regjimit, është një dëshmi e përpjekjes së fortifikimit të vendit dhe paranojës komuniste nga pushtuesit.

Tunelet e thella prej 30 metrash nën sipërfaqe paraqesin një teknologji të sofistikuar për kohën, duke ofruar mbrojtje ndaj sulmeve kimike dhe bërthamore. Këto korridore, me një gjatësi prej 7 kilometrash, kanë mure betoni të trasha rreth gjysmë metri dhe sisteme ajrimi të përsosura.

Një vizitë në këto tunele ju çon në një udhëtim interesant, ku mund të shihni se si ishte i organizuar një vendbanim i plotë nën tokë. Me kapacitet për 16 mijë banorë për 6 muaj, tunelet kishin një strukturë komplekse që përfshinte furrën e bukës, shkollën, spitalin, maternitetin, prokurorinë, stacionin e policisë, stacionin e radios dhe shtypshkronjën për propagandën komuniste.


Në këtë ambient, mund të shihni edhe hapësira të caktuara për aktivitete të ndryshme, nga klasat për fëmijë deri te trajnimet ushtarake për burra dhe gra. Tunelet kishin edhe bllokime strategjike për të parandaluar hyrjet e padëshiruara në raste pushtimi. Kjo infrastrukturë nëntokësore ishte pjesë e një sistemi të fortifikuar dhe konsiderohej si mbrojtja më e madhe në atë kohë për Shqipërinë. Për të lidhur këtë infrastrukturë nëntokësore me qytetin, tunelet ishin të lidhura me puse vertikale në të gjitha lagjet, duke siguruar qasje të lehta dhe të sigurta për banorët.^{2 3 4}

Kukësi i
nëndheshëm

Foto nga
Urban Research
Institute, 2023



Shtrirja kohore e historisë



Monumentet Historike

Kalaja e Shëmrisë

Kalaja e Shëmrisë ndodhet në një vend të njohur si "Qafa e Qytezës". Ajo është ndërtuar mbi një kodër me formë konike dhe ka një mur rrethues i cili përfaqon kodrën.

Kalaja e Domajve

Kalaja e Domajve, e njohur edhe si 'Kepi i Kalasë', gjendet në zonën e Ujmishtit. Ashtu si edhe shumë kala të tjera, muret e saj janë ndërtuar me gurë cilësorë. Gërmimet arkeologjike në këtë vend kanë zbuluar relike interesante, që hedhin dritë mbi historinë e kalasë dhe zonës përreth saj.

Foto nga "Kështjella e vonë antike e Domajve, Luan Përzhita"





Kalaja e Pecës

Kalaja e Pecës ndodhet në pikëtakimin e dy lumenjve. Drin i Bardhë dhe Lumë, në kodrën e njohur nga vendasit me toponimet "Kodra e Pecës", "Guri i Kalasë", etj. Ajo ngrihet në një terren shkëmbor me një pozitë të rëndësishme strategjike, që siguronte kalimin për në zonat fushore dardane nëpërmjet trasesë Lissus-Naisus.

Kalaja ka një formë të çrregullt dhe të ndërruar nga terreni, me një perimetër prej 445 metrash vendosur në 1 hektar sipërfaqe. Muri i kalasë është ndërtuar me gurë gëlqerorë të lidhur me llaç, ndërsa çatitë e banesave janë të mbuluara me tjegulla. Banesat vetë janë të stilizuara në mënyrën "alpine", të ngritura me mure që nuk i kalonin 1.5 metra.

Foto nga Arkeoal, 2020





Skicë e mureve rrethuese, Kalaja e Pecës, Luan Përzhitë, 1990⁵



Skicë e llojeve të vorbave të zbuluara nga gërmimet, Luan Përzhitë, 1990⁶



Skicë e llojeve të vorbave të zbuluara nga gërmimet, Luan Përzhitë, 1990⁷



Foto Instituti i Kërkimeve Urbane, 2023

Historia e kësaj kalaje shtrihet në katër periudha të ndryshme:

shekulli
VI-V p.e.s

Periudha e parë lidhet me shekullin VI - V p.e.s., ku gërmimet arkeologjike kanë zbuluar qeramikën e kësaj periudhe, duke përfshirë kupat me buzë të mbledhura nga brenda, tasat gjysmë sferike me vijëzime të veçanta dhe enët me grykë të shkurtër.

shekulli
III-II p.e.s

Periudha e dytë nis me gjurmët e mureve rrethuese, të cilat datojnë në shekullin III - II p.e.s. Gërmimet tregojnë për zhvillimin e disa banesave, të cilat sot ruajnë vetëm dyshtemenë e shtruar me dhe të kuq. Qeramika e kësaj periudhe përfshin enët me vorba pa vegje, të shkurtra dhe cilindrike.

qeramika
e kuqe

Periudha e tretë karakterizohet nga qeramika me ngjyrë të kuqe të çelët me pak shkëlqim. Gërmimet kanë zbuluar fragmente të ndryshme kupash, tasesh, amforash dhe oinohesh.


shekulli
III-IV e.s

Periudha e katërt është më mbizotëruese dhe lidhet me ndërtimin e kompleksit arkitektonik të kalasë. Muret rrethuese, bazilika, shkallarët dhe godinat janë disa nga elementët e kësaj periudhe, e cila daton në shekullin III-IV të erës sonë. Banesat kanë formë drejtkëndore me mure të trasha dhe lidhje të gurëve me balte, ndërsa hyrjet në kala janë të gjera dhe të vendosura në pjesën veriore. Gjithashtu, janë gjetur edhe disa pitosa në grykën e të cilave shihen disa vula në të cilat lexohet: OUEIKEIS (UIKIS) dhe QUEKEIS (KUIKS).

Kulla e Kosovës

Kjo kullë është një dhuratë e Kosovës për Kukësin, ndërtuar në vitin 2009 si kujtesë për shqiptarët e Kosovës që strehoheshin në vitin 1999 në këtë qytet. Brenda saj janë ekspozuar foto që pasqyrojnë realitetin e asaj periudhe.

Foto nga Lori Elezi, 2014




Muzeu Etnografik i Kukësit

Muzeu, i vendosur në qendër të qytetit, është një ndërtesë e re dhe modeste. Ky muze ofron informacion të pasur për historinë, etnografinë dhe biodiversitetin e zonës.

Miniera e Gjegjanit

Në minierën e Gjegjanit, janë zbuluar shenja të hershme të përdorimit të saj për nxjerrjen e bakrit që datojnë në periudhën e bronzit, rreth 3000 vjet më parë.



Në **Brut** është gjetur statuja e mërkurit, hyjnisë së mbrojtjes së udhëtarëve edhe tregtarëve.

Etimologjia e Emrit

Emri i qytetit Kukës mendohet të vijë nga fjala latine "Quercus" (kurkus), që në shqip përkthehet "bungaje". Kjo është teoria për etimologjinë e emrit të qytetit.

GJEOGRAFIA DHE KLIMA

Gjeografia dhe Klima

sipërfaqe prej 933.89 km²

Me një sipërfaqe prej 933.89 km², Bashkia e Kukësit ka një terren të pasur, me male të larta dhe sipërfaqe të ulëta në gropën e Kukësit dhe tarracat lumore të Drinit⁶. Lartësia varion nga 250 metra mbi nivelin e detit deri në 2,496 metra, maja e Gjallicës, e cila është pika më e lartë në Qarkun e Kukësit. Në veri dhe perëndim, Kukësi ndërlidhet me Alpet e Shqipërisë, që përfshijnë malin e Gjallicës, Koritnikun dhe Pashtrikut, ndërsa në jug dhe lindje, ndërlidhet me Malet e Korabit dhe të Sharrit.

Tipografia karstike dominon përbërjen gjeologjike të tokës, duke formuar një sistem të komplikuar shpellash, gropash, rrjedhje uji nëntokësore, por edhe tokë-formimeve të veçanta. Këto sisteme vetëm shtojnë vlerat e sistemeve ujore që Kukësi mbart. Kukësi është pikë ku takohen Drini Zi dhe Drini Bardh, duke ushqyer edhe liqenin artificial të Fierzës dhe formuar Lumin Drin, lumin më të gjatë në Shqipëri, me një gjatësi prej 280 km që derdhet në detin Adriatik.

klimë mesdhetare

Kukësi ndodhet në zonën e klimësmesdhetar paramalore dhe malore. Për shkak të variacioneve gjeografike, Kukësi gjithashtu ka mikroklimat e veta. Temperatura mesatare vjetore është 11.8°C dhe amplituda vjetore 21.5°C. Shiu është i përqendruar më tepër në shpatet perëndimore dhe jugperëndimore të vargmaleve dhe më pak në shpatet lindore, me shumicën e reshjeve (70%) gjatë periudhës vjeshtë-dimër.

Guri i Mëngjesit

Guri i mëngjesit është një formacion gjeologjik, i vendosur në pjesën jugore të Shishtavecit. Ky shkëmb, i njohur që në kohërat e lashta si pikë orientimi, është emëruar kështu për shkak të mënyrës se si rrezet e diellit në mëngjes formojnë një aureolë drite rreth tij. Ndodhet në një lartësi prej 1900 metrash mbi nivelin e detit, pranë kufirit me Kosovën.

Foto nga Trivet, 2021



Mali Gjallicës



Foto nga Visar Kola, 2012

Kanioni i Shkallës së Keqe

Kanioni i Shkallës së Keqe gjendet anësh pjesës jugore të malit të Gjallicës. Është monument natyror me thellësi rreth 1000 metra dhe një gjerësi prej vetëm 3 metrash në hyrje të tij.

Gjallica, me një lartësi prej 2489 metra mbi nivelin e detit, është mali më i lartë i qarkut të Kukësit dhe është pjesë e Alpeve Dinarike. Ky mal ndodhet në juglindje të qytetit të Kukësit, dhe i gjithë mali është i dukshëm nga çdo pikë e qyteti, duke ofruar një sfond të mahnitshëm. Pjesa e lartë e malit formon një kreshtë të mprehtë që zë vend në horizont. Shpatet e Gjallicës janë të thella dhe të pjerrëta, duke krijuar rrëpira të dukshme tektonik. Me një formë vezake me drejtim veri-lindor dhe jug-perëndimor, Gjallica duket sikur ngrihet si një piramidë gjigante mbi Rrafshin e Lumes, me një bazë prej rreth 11 kilometra dhe lartësi prej mbi 2100 metra. Në veri-lindje, Gryka e Vanave ndan Gjallicën nga mali i Koritnikut, ndërsa kanioni i Bicajt, i njohur ndryshe si "Shkalle e Keqe", shtrihet në jug-perëndim dhe është vendi ku përroi i Shejës kalon.

Mali i Gjallicës ofron një katalog të pasur të pasurive natyrore, me një shumëllojshmëri të florës dhe faunës, peizazhe të mahnitshme dhe burime ujore. Në të gjenden 4 kroje të njohura, Kroj i Kuq, Kroj Lanës, Kroj i Kishës dhe Kroj Tanzot. Secili nga këto kroje ka historinë dhe bukurin e vet.

Kroj i Kuq dhe Kroj i Tanzot lidhen edhe me Festën e Gjallicës, një festë me origjinë pagane që festohet të enjten e parë të muajit gusht, që është gjithashtu dhe mesi i verës. Pranë Kroit të Tanzotit, mbahen lutje e rituale nga komuniteti duke falënderuar malin.

Ky është kroj më i lartë në malin e Gjallicës, dhe emri vjen nga një gojëdhënë, sipas së cilës fuqitë e të gjithë zotave duhet të bashkoheshin për të nxjerrë ujin nga kroj.

Pjesëmarrësit e festës së Gjallicës njëherë që mbajnë lutjet pranë Kroit Tanzot zbresin pranë Kroit të Kuq, ku shijohen ushqime tradicionale, pihet rakia, zhvillohen lojëra, këndohen këngë dhe hidhen valle, e gjithë kjo e shoqëruar me instrumente popullore⁷.

Mali Koritnikut



Foto nga Faton Haxhiavdyli, 2018



Foto nga Pikellima, 2015

Mali Koritnik është një ndër malet më të rëndësishme në qarkun e Kukësit, me lartësi maksimale 2395 metra mbi nivelin e detit, në pikën e njohur si Maja e Pikëllimës. Dy cirqe akullnajore i kanë dhënë Majës së Pikëllimës një formë piramidale. Ky mal ngrihet mes Grykës së Vanave dhe Zëhrës së Prizrenit. Në pjesën jugperëndimore, ai pritet në mënyrë të thepisur prej Grykës së Vanave dhe fshatit Bele, ndërsa në pjesën verilindore ulet gradualisht në territorin Kosovar.

Biodiversiteti i malit të Koritnikut është i pasur. Mali është pjesë e Parkut të Natyrës Korab-Koritnik, duke formuar pjesë të Brezit të Gjelbër Evropianë. Është njohur si një zonë e rëndësishme për Bimësi në nivel ndërkombëtar nga organizata Plantlife. Në të gjenden 37 lloje gjitarësh, përfshirë dhe Rrëqebullin (*Lynx lynx*) i cili është i rrezikuar në mënyrë kritike për zhdukje.⁸

Rrëqebulli (*Lynx lynx*)



Mbulesa bimore dominuese përfshin Rrobullin (*Pinus Heldreichii*) në shpatin juglindor, dushqet dhe ahun në shpatin veriperëndimor (1800-2000 metra), dhe mbi këtë lartësi, gjenden kullota alpine.

Në Koritnik gjithashtu gjendet një bimë e rrallë, zambaku Shqiptar (*Lilium albanicum*), e cila është endemike dhe e kategorizuar si bimë e rrezikuar.

Një pjesë e fshatrave në këtë zonë festojnë festën e “së Qethmes”. Emri vjen nga tradita e mbajtur me kujdes. Të enjten e dytë të muajit shtator, banorët mbledhin bagëtitë në fusha dhe qethin delet një nga një. Ngjarja shoqërohet me një ritual, ku një dele bëhet kurban. Banorët dhe miqtë festojnë për 3 ditë. Për turistët, kjo është një mundësi unike për të njohur traditat vendase dhe për të përjetuar një festë autentike.

Zambaku Shqiptar (*Lilium albanicum*)



Rrobulli (*Pinus Heldreichii*)



Liqeni Fierzës



Foto nga Lapsi.al, 2023, Liqeni i Fierzës

Viti i krijimit:	1978
Gjatësi:	70 kilometra
Sipërfaqe:	7 mijë hektare
Lartësi nga niveli i detit:	167 metra
Thellësi:	128 metra
Vëllim:	2,7 miliardë metra kub ujë

Hidrografia e Kukësit është një thesar natyror i pasur. Ajo përfaqësohet nga rrjedhjet e lumit të Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë, dhe degët e tyre si lumi Lumës, i Bushtricës si dhe shumë përrenj dhe burime nëntokësore⁹. Një prej pikave më të rëndësishme është Liqeni Artificial i Fierzës. Ky liqen u krijua në vitin 1978, duke përdorur shtratin e lumit Drin për të krijuar hidrocentralin e Fierzës.

Liqeni i Fierzës shtrihet në një gjatësi prej 70 kilometrash, me një sipërfaqe maksimale prej 7 mijë hektarësh. Me një lartësi prej 167 metrash mbi nivelin e detit dhe një thellësi maksimale prej 128 metrash, liqeni arrin një vëllim prej 2,7 miliardë metra kub ujë.

Liqeni ka një shumëllojshmëri të peshqve, duke përfshirë ballëgjerin, krapin dhe luçiperkën. Pas mbushjes së basenit me ujë, fauna e liqenit të Fierzës është shtuar me lloje të ndryshme të peshqve, të cilët kanë gjetur një mjedis të favorshëm për t'u rritur dhe zhvilluar. Krijimi i liqenit ka ndikuar në zhdukjen e disa llojeve të peshqve të lumin Drin, por ka ndihmuar në shtimin e peshqve të liqeneve. Ndër llojet autoktone të gjetura në liqen janë guicaq, mylshi, njila, mrena, skorti i bardhë, ngjala e butë, trofta e liqenit, skorti i zi dhe sharmaku. Lloje të sjella janë krapin, ballëgjeri i bardhë, ballëgjeri larosh dhe pëllumbza.

Për turistët liqeni ofron një përvojë të mrekullueshme të natyrës, shëtitje me kanoe, dhe peshkim.

BIODIVERSITETI



Biodiversiteti

Flora dhe fauna në qarkun Kukës përfaqësohen me një biodiversitet të pasur të ekosistemeve. Brenda territorit të tij gjenden ekosisteme liqenore, lumore, ligatinore, shpellore, shkurre mesdhetare, pyje dushku dhe ahu, pyje me pisha, kullote dhe livadhe alpine e sub-alpine. Flora është e përfaqësuar me një larmishmëri bimësh, si dhe bimë endemike si vjollca shqiptare, zambaku shqiptar (*Lilium albanicum* Griseb) dhe tulipani shqiptar (*Tulipa albanica*).

Për shkak të shtrirjes së madhe vertikale të territorit bimësia shkallëzohet në breza të ndryshëm si brezi i shkurreve, brezi i dushkut, ahut dhe kullotat alpine.¹⁰

Fauna përfaqësohet me llojet tipike të gjetura në Ballkan, si ariu, ujku, dhelpra, derri i egër etj., por edhe specie autoktone nga të cilat vlen të përmendet rrëqebulli (*Lynx lynx balcanicus*), një nën-specie e rrallë e rrëqebullit euro-aziatik. Mendohet të jenë më pak se 50 individë të mbetur.¹¹ Në Kënetën e Kashtës, që ndodhet 5 kilometra larg qytetit të Kukësit, ndodhen rreth 17 lloje të ndryshëm shpendësh si çafka e bardhë (*Egretta alba*), çafka e kënetës (*Erdeola ralloide*) dhe së fundmi listës i janë shtuar dhe dy lloje, Gjelazi i madh dhe Kalorësi.¹²

Ndërkohë, ekosistemet shpellore aq sa të mahnitshme janë ende të pa eksploruara. Mendohet të kenë një varietet specimesh karakteristike të këtyre ekosistemeve, si lloje të veçanta merimangash, insektesh dhe jo-vertebrorë të tjerë, si dhe disa lloje lakuriq nate. Në këto shpella mendohet që jeton dhe një specie e veçantë, *Proteus anguinus*, i njohur si peshku-njeri.¹³



Proteus anguinus

750 lloje bimë medicinale

Kukësi ka më shumë se 750 lloje bimë medicinale, si duhani i egër, dëllinja e zezë, salepi, etj..¹⁴



Duhani i egër



Dëllinja e zezë



Salepi

Fauna

Zbuloni kafshët e egra të Parkut të Natyrës Korab-Koritnik, pjesë e mrekullueshme e Brezit të Gjelbër Evropian. Ky park natyror është një oaz i mbrojtur dhe i njohur për pasurinë e tij natyrore.




Dhi e egër
(*Rupicapra rupicapra*)



Dhelpër (*Vulpes vulpes*)




Derr i egër (*Sus scrofa*)



Ujk (*Canis lupus*)



Lepur
(*Lepus europeus*)



Shqarth
(*Martes foina*)



Rrëqebull (*Lynx lynx*)



Mace e egër (*Felis silvestris*)

Flora/ Lulet e Kukësit

Lulja Narcisit (*Narcissus poeticus*)¹⁶

Narcissus poeticus është një lule e bukur, me aromë të mirë, e cila rritet në zonën e Novosejtit. Në Reçicë gjenden livadhe të mbushura me lulen e narcisit në periudhën e saj të lulëzimit.

Troli (*Trollius europaeus*)

Trollius europaeus është një bimë barishtore e cila rritet në livadhet e Kallabakut. Lulëzon gjatë periudhës maj-korrik. Është helmuese nëse konsumohet.

Karafili madhështor (*Dianthus superbus*)

Dianthus superbus është një lule e bukur me nektar të ëmbël, që mund të hahet ose pihet pasi është zier në formën e çajit. Rritet në kullotat alpine të Shishtavecit pranë Gurit të Mëngjesit.

Shafrani i Sharrit (*Crocus scardicus*)

Crocus scardicus është një bimë endemike që gjendet në zonën e Korab-Sarakolit dhe Kallabakut. Kërkon kushte shumë të veçanta për të lulëzuar dhe për t'u rritur.



Karafili Madhështor
(*Dianthus superbus*)



Troli
(*Trollius europaeus*)



Lulja Narcisit
(*Narcissus poeticus*)



Shafrani i Sharrit
(*Crocus scardicus*)

Aguliçja e vogël
(*Primula minima*)

Primula minima është një bimë barishtore me ngjyrë të fortë që lulëzon në periudhën e qershorit. Në vendin tonë gjendet në bjeshkët e Sylbicë-Dobërdolit, rrëzë shkurreve dhe mjediseve shkëmbore.

Aguliçja e Hallerit
(*Primula halleri*)

Primula halleri është një tjetër lloj aguliçeje, po aq e bukur, që shtrihet në territorin tonë, nga fushat e Korabit deri në majat e tij.

Zambaku shqiptar
(*Lilium albanicum*)

Lilium albanicum është një zambak i veçantë, endemik i trevave të Shqipërisë. Rritet në zona të larta, si Mali i Pashtrikut¹⁷, bjeshkët dhe malet e Sharrit.

Narteca e Sharrit
(*Narthecium ossifragum*)

Narthecium ossifragum, me lule të verdha në formën e yllit, në shumë vende të Ballkanit përdoret për të zëvendësuar shafranin. Mbizotëron në bjeshkët e Dobërdolit, si dhe në majat e Korabit dhe Kallabakut.



Zambaku shqiptar
(*Lilium albanicum*)



Narteca e Sharrit
(*Narthecium ossifragum*)



Aguliçja e vogël
(*Primula minima*)



Aguliçja e Hallerit
(*Primula halleri*)

**Tulipani i
Kukësit**
(*Tulipa
Albanica*)

Tulipa Albanica është një bimë e rrallë me qepujkë, e cila shfaqet me dy ngjyra, të verdhë dhe të kuqe. Është endemike për malet e Kukësit dhe është një bimë në rrezik për zhdukje.



**Shtegu
i ngjyrave**

Shtegu i ngjyrave është 13 kilometra i gjatë, fillon nga Shishtaveci dhe mbaron në Çajë. Në periudhën Maj-Korrik me shkrirjen e akujve krijohet një peizazh mahnitës i mbuluar me lule shumëngjyrëshe.



KULTURA


Etnografia

Veshje burrash,
Lumë


Kukësi përfshin tre krahina etnografike: Lumën, Gorën dhe Malziun. Secila krahinë ka veshjet e veta, të dallueshme, të cilat pasqyrojnë një histori të pasur dhe kulturë të veçantë.

Në ilustrimin e mëposhtëm paraqiten veshjet për burrat dhe gratë nga krahina e Lumës. Dallimet kryesore midis zonës së Lumës dhe zonave të tjera fillojnë që nga tirqit apo pantallonat, të cilat në përgjithësi janë më të thjeshta, me një copë më të hollë dhe vetëm me një ose dy gajtanë.

Për sa i përket mbështjellakut, fundi i hapur në njërin anë, ku ka edhe zbukurime me pala të vogla, në zonën e Malziut është i kuq dhe me pala, ndërsa në zonën e Gorës është i kuq dhe prej leshi.¹⁸



Veshje grash,
Shëmbri



Shami Koke

Jeleku

Këmishë

KrahSAT

Brez


Shami Beli

Mbështjellëse

Çorape

Opingat

Veshje grash,
Lumë



Shami Koke

Xhybe

Anteri

Këmisha

Brez / Shoka

Mbështjellëse


T'linat

Opingat

Mundja

Mundja është një sport i veçantë për banorët e Kukësit, sidomos në zonën e Gorës. Ky sport është trashëguar gjeneratë pas gjenerate si një shfaqje e veçantë në dasma. Sot, Kukësi ka shumë sportistë të njohur në këtë disiplinë.

Foto nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 2023



Festat tradicionale

Në Bashkinë Kukës, kremtohen shumë festa lokale që lidhen me traditat dhe kulturën e vendasve.

Dita e Shën Gjergjit festohet në gjysmën e parë të majit që kremton fundin e dimrit dhe ardhjen e stinës së pranverës.

Dunmet festohet në Surroj me 20 shtator dhe është festë që lidhet me kthimin e bagëtive në fermat familiar nga kullotat verore në pllajat e maleve.

Të qethmet në zonën e Tërthores, të enjten e dytë të shtatorit. Është festë që lidhet me qethjen e deleve.

Gjallica festohet festohet të enjten e parë të muajit gusht dhe është festë pagane që lidhet me mbrojtjen e malit të Gjallicës.

Dita e verës festohet në të gjithë rajonin me 14 Mars.

Runa festohet në njësinë administrative Malzi me 1 korrik dhe është festë pagane ku njerëzit luten për fuqinë e malit.

Valle e shoqëruar me dajre dhe saze në Borje të Kukësit



Artizanati

Historia e artizanatit në Kukës është e thellë dhe e rrënjësuar në traditat e lashta të punimit të leshit, veçanërisht në prodhimin e veshjeve dhe qilimave që i nevojiteshin një shtëpie. Motivet popullore të përdorura në prodhimin e qilimave dhe sixhadeve janë të veçanta për këtë rajon, duke pasqyruar një shije të hollë artistike. Në vitet 1963, një ndërmarrje artizanati u themelua në Kukës, fokusuar kryesisht në prodhim për eksport dhe duke punësuar qindra punëtorë. Me ndryshimin e sistemit politik në vitet 1990, ndërmarrjet artistike u mbyllën, duke shkaktuar një rënie të madhe në prodhimin e artizanatit lokal. Megjithatë, një numër i vogël mjeshtrish vazhdojnë të mbajnë traditën gjallë, duke prodhuar qilima, sixhade dhe veshje popullore edhe në këtë zonë.

Veshje Tradicionale Kukës



Skano

Veshje Tradicionale Kukës
Mimoza Rata një artizane nga Kukësi, ka një dyqan ku ekspozon veshjet tradicionale të krijuara me pasion. Krijimet e saj janë të kërkuara edhe në nivel ndërkombëtar. Me dashuri dhe përkushtim, ajo po përpiqet t'ia përcjell zanatin vajzave të saj.



Mimoza Rata



+355 684536877



Artizanalet HM



Skano



Skano

Artizania Hate Ora është rritur në një ambient ku të gjitha gratë e familjes punonin në tezhgah qilima, sixhade, shtroje të ndryshme, veshje dhe aksesore të tjerë. Në fillim të viteve 1980, Hate u punësua në ndërmarrjen e artizanatit të Kukësit, ku punoheshin sixhade për eksport jashtë vendit. Pas mbylljes së ndërmarrjes. Hate e mbajti gjallë këtë traditë, fillimisht duke punuar në shtëpinë e saj dhe më pas duke ngritur një nga punishtet më të njohura në Kukës. Sot, punishtja menaxhohet nga vajza e saj Mikaela, të cilës dhe ia ka trashëguar zanatin dhe ndër të tjera shërben edhe si shkollë për ata që kanë interes në këtë zanat.




Mikaela Lala



Rruga 'Universiteti', Lagjja 1, Ndërtesa 1, Kukës




+355 696654094




Bee - Qëndistari Bleta





Skano 



Skano 

Bee ofron një gamë të gjerë të veshjeve popullore, suvenireve dhe dhuratave të personalizuar, të cilat reflektojnë trashëgiminë, kulturën dhe bukurinë e Kukësit.


 Rruga "Nënë Tereza",
Lagje 5, Kukës

 +355 693231957





Punime Dore Leshi




Skano 

Liria Kotarja, duke pasuar traditën e mësuar nga nëna, përdor teknikat e vjetra dhe inovacionin për të krijuar punime tradicionale me vlerë. Nga sixhadet dhe shokat te aksesorët moderne, leshi i deles gjen një përdorim të gjerë në krijimtarinë e saj. Procesi i përpunimit dhe ngjyrosjes i shton vlerë punimeve. Punime të veçanta, ruajtura me fanatizëm për më shumë se 50 vjet, tregojnë pasurinë e trashëgimisë së artizanëve të Shajakut, duke bërë këtë punishten një destinacion tërheqës për blerësit që dëshirojnë të kenë një pjesë të kësaj tradite në shtëpinë e tyre.

 Rruga e Ushtarakëve, Kukës

 +355 682509631

 ermentakotarja@outlook.com



Kuzhina

Kuzhina e Kukësit paraqitet me një gastronomi të thjeshtë, por të pasur me larmishmëri shijesh, ku shija e produkteve vendase është fokusi kryesor. Disa ushqime tradicionale që nuk duhet të humbisni pa provuar përfshijnë peshkun e liqenit të Fierzës, flinë, që është një formë byreku i thjeshtë i gatuar në saç, patatet në prush dhe shumë të tjera. Një pjatë tjetër karakteristike është çorba, një lloj supe që gatuhet me të brendshmet e bagëtive, ku shtohet edhe kos ose qumësht.¹⁹

Element tjetër që nuk mungon kurrë në një tavolinë Kuksiane janë turshitë, specat e mbushura me gjizë dhe domatet. Katalogu i ushqimeve vazhdon me pjata të ndryshme, si fasulet dhe pastërmanë, e cila gatuhet gjithashtu me fasulet për t'i dhënë më shumë shije lëngut të tyre.

Për sa i përket pijeve, Kukësi njihet për rakinë e shtëpisë por edhe bozën, e cila karakterizohet nga përdorimi i miellit të misrit. Përveç bozës, përdoret gjithashtu lëngu i dardhës, i cili shërbehet si shurup, si dhe lëngu i thanës. Kumbullat dhe mollët bëhen hoshaf, duke u tharë në diell. Mund të shërbehen si stafidhe ose mund të përdoren për të bërë komposto.

Disa restorante tradicionale të zonës janë “Kulla e Lumës”, “Oda Kuksi”, “Lugina e Drinit”, “Shtegu i Gjelbër”, etj.



Procesi i bërjes së flisë



Petë misri

SHTIGJET

MË TË REJA NË KUKËS

SHTIGJET MË TË REJA NË KUKËS

Zbuloni shtigjet më të reja të ecjes në Kukës, të hapura gjatë vitit 2023 nga Instituti i Kërkimeve Urbane në bashkëpunim me Bashkinë Kukës, në kuadër të projektit “Shtigje Eko-Turizmi në Zonën Ndërkufitare për Promovimin e Turizmit Alternativ”, mbështetur nga programi IPA II CBC Shqipëri-Kosovë 2014-2020, bashkë-financuar nga Bashkimi Evropian. Hapja e shtigjeve ka përfshirë pastrimin, shënjimin, dhe pajisjen me sinjalistikë dhe tabela informuese, duke ofruar një përvojë të pasur në natyrën e bukur dhe traditat e zonës së Kukësit.



Fotot nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 2023

SHTEGU 1

UJËVARA BELE

ZBINEC

QAFA E ZBINECIT



Shtegu 'Ujëvara Bele - Zbinec - Qafa e Zbinecit'

Informacion mbi shtegun

Gjatësia:	8 km
Shkalla e vështirësisë:	Mesatare
Prurjetimi:	Vajtje - Ardhje
Kohëzgjatja:	4 orë
Lartësia maksimale:	1271 m
Lartësia minimale:	453 m
Aksesi:	Pranverë - Verë - Vjeshtë

Shtegu "Ujëvara Bele - Zbinec - Qafa e Zbinecit" është një shteg ecje i cili kombinon ecjen në natyrë me eksplorimin e traditës autentike të zonës së Kukësit. Shtegu fillon në Ujëvarën Bele, një ujëvarë me ujë të kaltër dhe të pastër dhe përfundon në Qafën e Zbinecit, nga ku mund të shihet një pamje e mrekullueshme e qytetit të Kukësit dhe maleve që e rrethojnë.

Ura e Zarifes Nisja në këmbë bëhet nga pika ku mund të parkohen makinat në afërsi të Kanionit të Vanave ose në vendin e quajtur Ura e Zarifes (Ura e Lojmës). Nga aty fillon nisja e shtegut.

Ujëvara e Beles

Pas 180 metrave do të hasim Ujëvarën e Beles, një nga thesaret e shtegut, pjesë e parkut natyror Korab-Koritnik, e listuar edhe si monument natyre. Kjo ujëvarë është një vepër e rrallë e natyrës. Ajo karakterizohet nga një gjatësi prej 15 metra dhe gjerësi prej 1 metri. Uji zbret nga një shkëmb i lartë dhe thepësur dhe krijon një pishinë të vogël e të cekët nën të. Ujëvara është rrethuar nga pemë dhe barishte jeshile, që krijojnë një kontrast me gurët gri.

Shpella e Jezinës

4 lloje të rralla të lakuqiqëve të natës

Në Kanionin e Vanave, në afërsi të fshatit Bele ndodhet shpella e Jezinës. Në një lartësi prej 850 metra mbi nivelin e detit, ajo strehon 4 lloje të rralla të lakuqiqëve të natës të zonës së Ballkanit. Gjatë verës, temperatura brenda shpellës është konstante rreth 15 gradë Celsius, ndërsa gjatë dimrit ajo ulet deri në 12 gradë Celsius. Brenda shpellës, në muret e saj, do të hasni forma të ndryshme të stalaktiteve dhe stalagmiteve, të cilat janë krijuar gjatë miliona vitesh. Hyrja e shpellës është e veçantë, me një lartësi prej 10 metrash dhe e hapur. Po ashtu, brenda saj gjeni një burim uji që rrjedh gjatë shumicës së vitit.

Përroi i fshatit

Fshati Bele

Pasi kalohet ujëvara, do shohim përroin e fshatit, i cili furnizon dhe ujëvarën me ujë. Duke ndjekur shatin e përroit, udhëtimi do të vijojë me ngjitjen drejt fshatit Bele, një fshat tradicional që dallon për mikpritjen dhe shtëpitë karakteristike me gurë, të ndërtuara në formën e kullave. Fshati është pjesë e njësisë administrative Zapod në Bashkinë e Kukësit. Zona përreth Beles është e njohur për peizazhet malore dhe natyrën e saj të pasur të cilën do vazhdojmë ta eksplorojmë në këtë shteg.

Bjeshkët e Zbinezit

Shtegu vazhdon për në bjeshkën e Zbinezit, ku do të keni mundësinë të shikoni stanet dhe një numër të madh bagëtish që e karakterizon qartë si një zonë blegtorale. Para viteve '90, në Zbinez ndodheshin 2 stalla të mëdha të cilat mbarështonin rreth 800 krerë dhi dhe 100 krerë lopë. Gjatë kësaj periudhë, funksionale ka qenë edhe një qendër për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e bulmetit. Ngjitja nga Zbinez për në Qafën e Zbinezit zgjat afërsisht 10 minuta, nga aty mund të shihet një pamje të mrekullueshme të qytetit të Kukësit dhe rrafshit të Lumës.

Qafa e Zbinezit

Me bukuritë e maleve dhe natyrën e pasur Kukësi të surprizon edhe me bimësinë e saj, zona njihet për sherbelën dhe trumzën të cilat banorët e zonës i mbledhin gjatë stinës së verës.

Aktivitete të tjera që mund të bëhen në këtë shteg përfshijnë motocross, kamp, eksplorimin e natyrës dhe peizazhit të bukur, si dhe fotografimi.

Shtegu ka një nivel vështirësie mesatare dhe kërkon kushte të mira fizike dhe pajisje për mal (Këpucë për ecje, çantë shpine, veshje kundër lagështisë, syze dielli, krem dielli, ujë – min. 1 litër, ushqim ditor, shkopinj për ecje me dëshirën për lehtësimin e ngjitjes, ndriçim, telefon mobil etj.)




Foto nga Trivet, 2021

Shtegu Ujëvara Bele, Zbinec, Qafa e Zbinecit

Trail of Bele Waterfall, Zbinec, Zbinec Neck

- 1 Ujëvara e Beles
Bele Waterfall
- 2 Përroi i Fshatit
Village Stream
- 3 Fshati Bele
Bele Village
- 4 Shpella e Jezinës
Jezinë Cave
- 5 Zbinec
Zbinec
- 6 Qafa e Zbinecit
Zbinec Neck

Informacion mbi shtegun

Akresi: Pranverë - Verë - Vjeshtë
Access: Spring - Summer - Autumn

Shkalla e vështirësisë: Mesatare
Technical difficulty: Moderate

Rrugëtimi: Vajtje - Ardhje
Travel: Out-and-back

Kohëzgjatja: 5 orë
Duration: 5 hours

Information on the trail


Gjatësia: 8 km
Length: 8 km

Lartësia maksimale: 1271 m
Max elevation: 1271 m

Lartësia minimale: 453 m
Min elevation: 453 m



Vende të përshtatshme për kamping
Suitable places for camping



SHTEGU 2

ZBINEC

PYLLI I BOZHOLAZIT

**LIVADHET DHE
STANET E POBREGUT**

STANET E GJEGJANIT

KROI KINZËS



Shtegu 'Zbinec – Pylli i Bozholazit – Livadhet dhe Stanet e Pobregut – Stanet e Gjegjanit – Kroi Kinzës'

Informacion mbi shtegun

Gjatësia:	6 km
Shkalla e vështirësisë:	Mesatare
Rrugëtimi:	Vajtje – Ardhje
Kohëzgjatja:	4 orë
Lartësia maksimale:	1779 m
Lartësia minimale:	1281 m
Aksesi:	Pranverë - Verë - Vjeshtë

Shtegu "Zbinec - Pylli i Bozholazit - Livadhet dhe Stanet e Pobregut - Stanet e Gjegjanit - Kroi Kinzës", i cili shtrihet në zemrën e natyrës së Kukësit, është një udhëtim mbresëlënës për çdo adhurues të natyrës dhe aventurës. Ky shteg fillon në bjeshkën e Zbinecit, duke vazhduar përmes pyllit të Bozholazit, dhe përfundon në Kroin e Kinzës, një vendndodhje historike dhe natyrore.

Zbinec

Pylli i Bozholazit

Në fillim të shtegut në Zbinec, vizitorët mund të shijojnë pamjen e bukur të fshatit, si dhe mund të shijojnë natyrën e pyllit të Bozholazit. Gjithashtu, këtu mund të shihet edhe "kloni kufitar" i krijuar gjatë komunizmit. Kloni ishte një mur me tela të fortë me gjemba, i ngritur në formën e një perdeje vertikale të hekurt, mbi dy metra e lartë, mbështetur në shtylla betonarme. Kloni nuk ishte ekzaktesisht në vijën e kufirit por, më brenda tij në tokën shqiptare, pranë piramidave kufitare që tregonin ndarjen mes Shqipërisë dhe Kosovës. Në të dy anët e klonit ndodhej i ashtuquajti brezi i butë, që ishte një rrip toke vërtetë e butë, e punuar freskët, një brez pra me gjerësi 4 m në secilën anë të klonit, me qëllim që në të, të mbeteshin gjurmët e atyre që do të kalonin kufirin, për ata që do të arratiseshin.

Livadhet dhe stanet e Pobregut dhe Gjegjanit

Shtegu vazhdon nëpër pyll dhe livadhe, duke kaluar nga stanet e Pobregut dhe Gjegjanit, të cilat ofrojnë pamje të mrekullueshme të kësaj zone, dhe ku do të keni mundësinë të shikoni stanet dhe një numër të madh bagëtish që e karakterizon qartë si një zonë blegtorale. Gjatë luftës së Kosovës, shumë nga livadhet në këtë pjesë të shtegut janë përdorur si kampe nga brigadat e UÇK-së për të përgatitur veten për luftë, koordinim ose grumbullim armësh.

Kroi i Kinzës

Me vijimin e shtegut do të arrijmë te Kroi i Kinzës, një krua i ndërtuar për të furnizuar me ujë bagëtitë. Gjendet rrëzë malit të Korintikut dhe është burimi i vetëm i ujit në një hapësirë të gjerë. Ky burim është një vepër artizanale, me trungje pemësh të gdhendura me kujdes nga brenda për të funksionuar si mbajtëse uji.

Trungjet zbresin poshtë drejt të tokës dhe formojnë një vijë të gjatë, duke ruajtur një sasi të madhe uji. Kroi i Kinzës gjendet në një lartësi rreth 1800 metra mbi nivelin e detit dhe është i rrethuar nga livadhe me lule dhe gjelbërim.

Livadhi i Padinës

Nëse vendosni të ndiqni shtegun deri në fund, do të arrini në livadhin e Padinës, livadhi i bjeshkëve të përbashkëta të Kosovës dhe Shqipërisë. Gjithashtu Padina është edhe pika më e lartë e këtij shtegu, nga ku mund të shihet qyteti i Prizrenit dhe rrethinat, por edhe një panoramë e mrekullueshme e malit të Koritnikut.

Zona njihet edhe për aguliçen, një bimë barishtore e cila karakterizohet nga ngjyra rozë në vjollcë dhe çel kryesisht në periudhën e qershorit. Njihet si një bimë e cila lulëzon në Ballkan dhe shkon deri në Itali zona e Lombardisë Trentinos. Për nga brishtësia e saj konsiderohet një lule mjaft e bukur dhe e veçantë.

Aktivitete të tjera që mund të bëhen në këtë shteg përfshijnë motocross, kamp, eksplorimin e natyrës dhe peizazhit të bukur, si dhe fotografimi.

Shënim: Shtegu ka një nivel vështirësie mesatare dhe kërkon kushte të mira fizike dhe pajisje për mal (Këpucë për ecje, çantë shpine, veshje kundër lagështisë, syze dielli, krem dielli, ujë – min. 1 litër, ushqim ditor, shkopinj për ecje me dëshirën për lehtësimin e ngjytjes, ndriçim, telefon mobil etj.).



Foto nga Trivet, 2021



Shtegu Zbinc - Kroi i Kinzës

Trail
Zbinec - Kinza Fountain

- 1 **Oafa e Zbincit**
Zvinec Neck
- 2 **Stanet e Pobregut**
Pobregu Barns
- 3 **Stanet e Gjegjanit**
Gjegjan Barns
- 4 **Kroi i Kinzës**
Kinza Fountain
- 5 **Padina (Kosova)**
Padina (Kosovo)

Informacion mbi shtegun

Akresi: Pranverë - Verë - Vjeshtë
Access: Spring - Summer - Autumn

Shkalla e vështirësisë: Mesatare
Technical difficulty: Moderate

Rrugëtimi: Vajtje - Ardhje
Travel: Out-and-back

Kohëzgjatja: 4 orë
Duration: 4 hours

Information on the trail

Gjatësia: 6 km
Length: 6 km

Lartësia maksimale: 1779 m
Max elevation: 1779 m

Lartësia minimale: 1281 m
Min elevation: 1281 m



Vende të përshtatshme për kamping
Suitable places for camping

SHTEGU 3

GJEGJAN

Qafa e Zbincit

ZBINEC



Foto nga Instituti i Kërkimeve Urbane, 2023

Shtegu 'Gjegjan – Qafa e Zbinecit – Zbinec'

Informacion mbi shtegun

Gjatësia: 8 km

Shkalla e vështirësisë: Mesatare

Prurjetimi: Vajtje – Ardhje

Kohëzgjatja: 4 orë

Lartësia maksimale: 1273 m

Lartësia minimale: 453 m

Aksesi: Pranverë - Verë - Vjeshtë

Shtegu "Gjegjan - Qafa e Zbinecit – Zbinec" është një shteg ecje i cili ju çon nëpër peizazhet e bukura të zonës së Kukësit dhe historinë e pasur të kësaj zone. Shtegu fillon nga fshati Gjegjan, livadhe dhe stanet e Pobregut te cilat mbartin bukurri natyrore dhe vlera historike dhe vazhdon deri në Qafën e Zbinecit dhe përfundon në Zbinec.

Gjegjan Shtegu fillon në Gjegjan, një fshat në njësinë administrative Terthorë, në Bashkinë e Kukësit. Në fshatin Gjegjan mund të shihet pisha e Gjegjanit e cila është e listuar si monument natyre.

Pisha 400 Vjeçare Pisha është të paktën 400 vjeçare e mbjelle në kohën e pushtimit turk. Sipas banorëve kanë qenë mbjellë 3 të tilla, në Tregtan të Hasit, në Gjegjan dhe në Morinë, por vetëm pisha e Gjegjanit ka mbijetuar. Në këtë pishë dikur banorët e zonës mblidheshin dhe festonin festën e të "Qethmes", ku gostisnin, vallëzonin dhe këndonin për 3 ditë e 3 net.

Stanet i Pobregut

Me vijimin e shtegut ecim nëpër livadhe ku mund të përjetojmë qetësinë dhe bukurinë e natyrës që ofron kjo zonë për të arritur në Stanin e Pobregut. Gjatë viteve 1998-1999 në Stanin e Pobregut ndodhej baza logjistike e brigadës – 125 – Z.O.P – UÇK-së. Këtu do të keni mundësinë të shikoni stanet dhe një numër të madh bagëtish që e karakterizojnë këtë si një zonë blegtorale.

Qafa e Pobregut


Njëherë që arrijmë në Qafën e Zbinecit ofrohet një pamje e mrekullueshme e maleve të veriut të Shqipërisë. Shtegu përfundon në Zbinec, një zonë e bukur e cila ofron një pamje të qetë dhe relaksues, si dhe mundësi për të bërë piknik dhe për të shijuar natyrën.

Kafshë të shumta si ariu i murrmë (Ursus arctos), macja e egër (Felis silvestris), derri i egër (Sus scrofa), ujku (Canis lupus), kaproll, lepuri i egër, shqiponja, skifteri, etj., janë pjesë e faunës së egër të cilat janë karakteristike të kësaj zone. Ndër të tjera, të shohësh rrëqebullin e Ballkanit (Lynx lynx balcanicus) në natyrë konsiderohet shumë e rrallë, por ai është filmuar në brendësi të Parkut Natyror Korab-Koritnik, ku bie dhe ky shteg.

Aktivitetet e tjera që mund të bëhen në këtë shteg përfshijnë motocross, eksplorimin e natyrës dhe peizazhit të bukur, si dhe fotografimi.

Shënim: Shtegu ka një nivel vështirësie të lehtë në mesatare, por kërkon kushte të mira fizike dhe pajisje për mal (Këpucë për ecje, çantë shpine, veshje kundër lagështisë, syze dielli, krem dielli, ujë – min. 1 litër, ushqim ditor, shkopinj për ecje me dëshirë për lehtësimin e ngjitjes, ndriçim, telefon mobil etj.).





Shtegu Gjegjan - Zbinec

Trail
Gjegjan - Zbinec

- 1 Gjegjan
Gjegjan
- 2 Pisha e Gjegjanit
Gjegjan Pine
- 3 Livadhet
Meadows
- 4 Stani i Pobregut
Barns
- 5 Qafa e Zbinecit
Zvinec Neck

Informacion mbi shtegun

Aksesi: Pranverë - Verë - Vjeshtë
Access: Spring - Summer - Autumn

Shkalla e vështirësisë: Mesatare
Technical difficulty: Moderate

Rrugëtimi: Vajtje - Ardhje
Travel: Out-and-back

Kohëzgjatja: 4 orë
Duration: 4 hours

Information on the trail

Gjatësia: 6 km
Length: 6 km

Lartësia maksimale: 1273 m
Max elevation: 1273 m

Lartësia minimale: 453 m
Min elevation: 453 m

 Vende të përshtatshme për kamping
Suitable places for camping

Guida turistike

Në Kukës mund të përjetoni një udhëtim të jashtëzakonshëm duke përdorur shërbimet e guidave kombëtare dhe lokale të cilat janë jo vetëm profesioniste, por edhe të certifikuara. Këto guida të kualifikuara do t'ju ofrojnë një eksperiencë unike rreth bukurive të Kukësit.

Afrim Cenaj

Guidë lokale afrimcenaj12@icloud.com +355685520330
reniscenaj111@gmail.com +355676653708

Liridon Kastrati

Guidë kombëtare liridonk341@gmail.com +355684491695

Alban Xhaferri

Guidë lokale albanxhaferri93@gmail.com +355684491695

Labiot Gjana

Guidë lokale gjanalabi@gmail.com +355693786161


Ijaz Gjana

Guidë lokale iljazgjana2@gmail.com +355692286688

Kontakte të nevojshme

Kodi postar:

8501, 8502, 8503



Policia:

129



Zjarrëfikëse:

128



Ambulanca:

127



Shërbimi Emergjencës:

112



Transporti

Me autobus



Stacioni i Autobusëve jo zyrtar në Kukës është i vendosur pranë Ish Hotel Parku. Për udhëtimet brenda dhe jashtë qytetit, linjat e autobusëve të rregullta ofrohen për destinacione si Tirana, Peshkopia dhe Bajram Curri. Autobusët nga Tirana operojnë çdo orë, nga ora 06:00 deri në 19:00. Nëse dëshironi të planifikoni udhëtimin tuaj me autobusë, mund të përdorni shërbimin e platformës online **www.travel.gjirafa.com**, ku do të gjeni informacione të detajuara dhe mundësi për organizimin e udhëtimit tuaj në mënyrë të lehtë. Përveç autobusëve, është gjithashtu mundësia për të përdorur fugonat, të cilët ofrojnë orare të ndryshme udhëtimi drejt Kukësit.

Me Makina me Qira



Një tjetër mënyrë për të udhëtuar drejt Kukësit është me makina me qira. Ky opsion i ofron përdoruesve një mjet të pavarur dhe të personalizuar për të eksploruar zonën në mënyrë të rehatshme.

Europcar

Kukës International Airport +355 45800600
info@europcar.com.al

Albania Airport Rent a Car

Kukës International Airport +355684011010
info@albaniaairportrentacar.al

Rent a Car Mara

Kukës International Airport +355 693282233

Enterprise Rent-A-Car

Kukës International Airport +355 676018857
info@albaniacarrentals.com

AutoUnion

Kukës International Airport +355 694040042
info@mbrentacar.com

G Rentals

Kukës International Airport +355 684099933
kontakt@grentals-ks.com

3 Elezi Agency Rent a Car

+355 683931155

Referenca

1. University College London INSTITUTE OF ARCHAEOLOGY BULLETIN Number thirty: 1993
2. Qyteti i nëndheshëm i Kukësit, topografi Koliçi: T'i pastrojnë tunelet, në rast lufte strehohemi këtu! Ja çfarë kemi ndërtuar gjatë viteve 80' (VIDEO) - FaxWeb
3. Nëpër Tunelet e Kukësit të Nëndheshëm - Dritëhijet Historike të Tre Qyteteve - Into Albania
4. Tunelet ushtarake në nëntokën e Kukësit, reflektim i jetës gjatë komunizmit - Lajmet e fundit - Zëri (zeri.info)
5. Kështjella e Pecës në periudhën e Antikitetit të vonë dhe Mesjetë (rrethi i Kukësit)
6. Libri " Qarku i Kukesit "-Nasip Meqaj & Maxhun Did
7. Gjalica Dodona e Dardanëve, Nazif Dokle
8. Parku Natyror Korab-Koritnik, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrotura (AKZM)
9. Qarku i Kukesit - Nasip Meqaj & Maxhun Dida
10. <https://kukesi.gov.al/muze/>
11. <https://akm.gov.al/wp-content/uploads/2022/04/Permbledhje-joteknike-LEJE-TIPI-B-VNMTH-2.pdf>
12. <https://ppnea.org/portfolio-item/rreqebulli-i-ballkanit/>
13. <https://www.slideshare.net/MetiMuja/biodiversiteti-ne-komunen-e-kukesit>
14. <https://planifikimi.gov.al/index.php?eID=dump-File&t=f&f=2213&token=c99d06ab7c5b5a84b724d-de3142333623c17ce9c>
15. <https://ppnea.org/jeta-e-eger-ne-rajonin-nderkufitar-korab-koritnik-sharr/>
16. <https://www.intoalbania.com/sq/10-bimet-e-rralla-te-kukesit-me-vlera-turistike/>
17. Shuka, L., Mullaj, A., P., H., Kashta, L., Miho, A. (Year). "Review of Flora and Vegetation in the Albanian Alps: Conservation Status and Threats."
18. Një guidë për Kukësin, Hamit Noka
19. Qarku i Kukësit - Nasip Meqaj & Maxhun Dida Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë (bksh.al)



 **ECO-ROUTES**

© 2023